

VENDIM
Nr.805, datë 6.12.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.527, DATË 2.8.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË TRE ANËTARËVE TË ENTIT
RREGULLATOR TË UJIT (ERRU)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 4 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit e të përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.527, datë 2.8.2006 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Në titull shprehja “...tre anëtarëve të Entit Rregullator të Ujit (ERRU)...” zëvendësohet me “...tre anëtarëve të komisionit kombëtar rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit e të përpunimit të ujërave të ndotura...”.

2. Në paragrafin e parë të tekstit bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Shprehja “Emërimin anëtarë të Entit Rregullator të Ujit...” zëvendësohet me “Emërimin anëtarë të komisionit kombëtar rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit e të përpunimit të ujërave të ndotura...”.

b) Shprehja “...të përzgjedhura nga Komisioni Kombëtar i Ujit...”, zëvendësohet me “...të përzgjedhura nga ekipi përzgjedhës...”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha